



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 22.29.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR PËR KOMUNËN E
KAMENICËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Komunës së Kamenicës*, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Qerkin Morina NAP*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga *Enver Ramadani udhëheqësi i ekipit dhe Donjetë Dreshaj e Naim Neziri anëtarë të ekipit*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të auditimit *Fatinda Ramosaj*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm.....	7
2 Qeverisja.....	11
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli.....	17
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit.....	25
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA	26
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak.....	29
Shtojca IV: Letër konfirmimi	34

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore të Komunës së Kamenicës për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 07.10.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Më hollësisht shih, Shtojcën 1.

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërdrejt cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Kamenicës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Si theksim i çështjes dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasuritë komunale ishin nënvlerësuar si rezultat i mos regjistrimit të tri (3) shkollave fillore të financuara nga donatorët si dhe pasurisë tjetër në vlerë 72,849€.


Për më gjerësisht, shih pjesën 1.1 të këtij Raporti.

¹ Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit"

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Edhe pse në disa fusha kontrollet e brendshme janë efektive, ekzistojnë dobësi në të hyra, shpenzime dhe pasuri.



Kryetari duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të fushave brengosëse të theksuara në këtë Raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe të ndërmerren veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet 7, 8, 9 dhe 13).

Përgjigja e Kryetarit të Komunës

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Më tutje Kryetari i Komunës është zotuar që:

- ta shqyrtoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- deri në fund të muajit janar 2018, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PFV 2017 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

Për më tepër shih shtojcën IV.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne, gjithashtu, e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Kamenicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi ynë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

Pasuritë komunale ishin nënvlerësuar:

- Për 50,000€ si rezultat i mos regjistrimit të rrugëve Bosce dhe Moqarë e Ulët, pjesa e bashkë financuar nga MAPL-ja në vlerë 50,000€ dhe ndërtimi i tri (3) shkollave fillore në Karaqevë të Epërm, Kamenicë dhe Strezovcë, të financuara nga donatorët e huaj; dhe
- Për 47,671€, si mungesë e regjistrimeve të duhura të rrugëve të asfaltuara dhe kanalizimeve, blerjeve të shërbimeve dhe pasurive kapitale në vlerë prej 22,180€.
- Ndërsa, pasuria ishte mbivlerësuar për 47,002€ për shkak të regjistrimeve të gabuara (mirëmbajtjes dhe shërbimeve për 29,142€ dhe subvencioneve të dhëna fermerëve prej 17,860€).

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Kryetari i Komunës së Kamenicës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është

relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Kryetari i Komunës kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).
- Nëse PFV janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në MF;
- Nëse Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit është dorëzuar me kohë; dhe
- Nëse Komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Kuvendi Komunal dhe tek MF.

Draft PFV fillestare përmbanin disa gabime financiare dhe ne i kemi dhënë komunës disa sugjerime për të përmirësuar cilësinë e tyre, si në vijim:

- Te Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në para të gatshme tek Burimet e fondeve, pagesa nga palët e treta të jashtme është paraqitur në rreshtin Granti i përcaktuar i donatorëve, ndërsa do të duhej të paraqitet tek pranimet tjera. Ndërsa tek shfrytëzimi i fondeve është paraqitur tek shpenzimet kapitale, e do të duhej paraqitur tek pagesat tjera. Pagesat e palëve të treta do të duhej të shpalesën të shënimi shpjegues 8;
- Nuk ishte bërë shpalesje për shënimin 9 të hyrat tatimore në vlerë prej 266,740€. Ato janë përfshirë gabimisht në shënimin 10 tek të hyrat jo-tatimore;
- Tek Neni 14 Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit vlera e të hyrave jo tatimore është 585,480€ , ndërsa do të duhej të ishte 585,643€ (diferenca 163€);
- Tek shënimet shpjeguese 2, 3, 4, 5 dhe 6 të kolona e Buxhetit Final mungon shpalesja nëpër kode ekonomike edhe totali në këtë kolonë;

- Neni 24 Raport për fondet e donatorëve të pashpenzuara për bartje nuk janë shpalosur participimet e qytetarëve në vlerë 11,068€ dhe nuk figuron bilanci përfundimtar i vitit 2015; dhe
- Te Neni 19.3.1 Pasuritë Kapitale me vlerë mbi 1,000€ shuma totale e paraqitur është 60,855,970€ , ndërsa sipas raportit të pasurive do të duhej të ishte 60,244,590€.

Sugjerimet tona janë marrë parasysh nga komuna dhe gabimet e përmendura më lartë janë korigjuar, ndërsa në PFV finale ende kanë mbetur gabime që kanë të bëjnë me:

- Llogaritë e arkëtueshme për tatimin në pronë të prezantuara në PVF janë nënvlerësuar për 87,703€. Totali i deklaruar në PVF për tatimin në pronë është 1,240,710€ ndërsa shuma në raportin e vitit 2016 e gjeneruar nga protax është 1,328,413€;
- Klasifikim në kategori ekonomike të gabuara në vlerë 23,914€; dhe
- Mos prezantimi i saktë i pasurisë që është trajtuar tek baza për theksim të çështjes.

Kërkesat tjera të raportimit janë përmbushë dhe nuk kemi komente lidhur me to.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I KOMUNËS

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, me përjashtim të pasaktësisë së informatave të theksuara te opinioni i auditimit, por të cilat konsiderohen jo materiale.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e sipër përmendura jepet rekomandimi:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së Opinioni si dhe të ndërmerren veprime për përmirësimin dhe mos përsëritjen e tyre në të ardhmen. Gjithashtu, duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport dhe Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon përkushtimin e menaxhmentit se sa po i përmirëson proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Auditimi i Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda komunës veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial.

Një ndër elementet kyçe të një qeverisje efektive është edhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i jashtëm. Auditimi i këtij viti ka nxjerrë në pah se niveli i rekomandimeve të zbatuara nga viti i kaluar ishte i ulët, ku vetëm tri (3) nga 16 ishin zbatuar plotësisht.

Komuna nuk ka prezantuar një regjistër të rreziqeve, kërkesë kjo e procedurës numër katër të dokumentit të Thesarit “Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli”.

Lista kontrolluese e vet-vlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që nuk bazohen në dëshmi. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit, nuk janë të vendosura.

Komuna nuk ka një plan strategjik të përgjithshëm të objektivave, por kishte planin zhvillimor urban 2013-2018 dhe planin zhvillimor komunal 2013-2023.

Në vitin 2016, ka përdorur 95% të buxhet final me një përmirësim për 2% në krahasim me vitin paraprak. Kjo tregon një trend pozitiv në menaxhimin e buxhetit. Megjithatë në aspektin e pajtueshmërisë më legjislacionin, auditimi ynë ka shpalosë ekzistencën e disa dobësive të cilat përfshijnë kryesisht regjistrimin e pasurive dhe zbatimin e ulët të rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015 të Komunës së Kamenicës ka rezultuar në 16 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Raporti i auditimit ishte diskutuar në Kuvendin Komunal më datë 29.07.2016.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, tri (3) rekomandime janë zbatuar; gjashtë (6) janë zbatuar pjesërisht dhe shtatë (7) nuk janë zbatuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë zbatuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 2 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar sepse komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, kanë rezultuar në:

- Mos regjistrimin e plotë të pasurive;
- Vazhdimi i dobësive në fushën e të hyrave dhe shpenzimeve;
- Mos delegimi i përgjegjësive për menaxhimin e rrezikut; dhe
- Menaxhimin e dobët të qiradhënies së pronave komunale.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të aplikoj masa përgjegjësie ndaj personave të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve dhe sigurojë se plani i veprimit po zbatohet me kohë dhe në mënyrë efektive për të gjitha rekomandimet e dhëna, dhe me fokus të veçantë tek ato me prioritet të lartë. Progresi në zbatimin e rekomandimeve duhet t'i nënshtrohet rishikimeve sistematike nga Kryetari.

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentave të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuar në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese dhe kemi përmbledhur të gjeturat tona më poshtë. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit, por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 3 - Pyetësi i vet-vlerësimit - Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponenta. Nga çështjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

- Komuna nuk ka një regjistër gjithëpërfshirës të vlerësimit të rreziqeve, të cilat mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të komunës për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimin e tyre, si dhe të përcaktoj masat e duhura për reagim ndaj këtyre rreziqeve; dhe
- Komuna nuk kishte përgatitur një strategji gjithëpërfshirëse të zhvillimit, duke përfshirë edhe palët e interesit si dhe llogaritjen e kostos së plotë për implementimin e saj.

Për më shumë, veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetëvlerësimi i vitit 2015 është i limituar. Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së qartësisë me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

Rreziku Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të sigurojë se është hartuar strategjia zhvillimore gjithëpërfshirëse duke përfshirë palët e interesit dhe duke llogaritur kostot për implementimin e saj, si dhe të bëhet vlerësimi i rreziqeve me të cilat mund të ballafaqohet komuna.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit komuna operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës, si: planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal etj.

Çështja 4 – Mungesa e planit strategjik – Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna nuk posedon një strategji të përgjithshëm me objektiva afatgjata ku përshkruhet qartë zhvillimi në planet urbanistike, hapësinore, plani operativ emergjent, plani strategjik kundër korrupsionit, strategjia e zhvillimit rajonal dhe objektivat që duhet të arrihen në këto fusha. Komuna ka planin zhvillimor urban 2013-2018 dhe planin zhvillimor komunal 2013-2023.
- Rreziku** Mungesa e planit strategjik rrezikon prioritizimin e çështjeve kyçe të cilat kanë të bëjnë me orientimin dhe zhvillimin e komunës në periudha afatgjata dhe pamundëson përcjelljen e përmbushjes së objektivave në pikëpamje të vizionit si një ndër kushtet esenciale të qeverisjes së mirë.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të miratoj një plan të përgjithshëm strategjik për komunën i cili do të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbejë si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore, kryerjen e analizave krahasuese mes viteve dhe matjen e rezultateve kundrejt objektivave.

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Për të siguruar një menaxhim efektiv të aktiviteteve, nevojitet një proces efektiv i konsolidimit dhe raportim me kohë.

Çështja 5 - Dobësi në kontrollet menaxheriale- Prioriteti i lartë

- E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor të komunës ka nxjerrë në pah një raportim jo të mirë të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Raportimi më tepër bëhet në formë verbale se sa me shkrim. Kjo mënyrë e raportimit nuk ndihmon procesin e vendimmarrjes dhe llogaridhënien e menaxhmentit në përgjithësi..
- Rreziku** Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së dobët reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës, duke rezultuar me dobësi në procesin buxhetor si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare dhe vendimmarrjes me kohë.
- Rekomandimi 5** Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme gjatë muajve në vijim.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga drejtori dhe një auditor. Brenda afatit ishin kryer 10 auditimet e planifikuara, të cilat kishin fokus: të hyrat komunale dhe tatimin në pronë, prokurimin dhe shpenzimet, subvencionet dhe menaxhimin e pasurisë. Raportet e përfunduara janë të dokumentuara sipas kërkesave standarde për kryerjen e auditimit, përfshirë këtu përcjelljen dhe raportimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Çështja 6 - Zbatimi i rekomandimeve të NjAB - Prioriteti i lartë

E gjetura Rekomandimet e dhëna nga NjAB për vitin 2016 kishin ngecje në zbatim. Vetëm një numër i vogël i tyre ishin zbatuar plotësisht apo shprehur në përqindje 38 % e tyre.

Ky rezultat tregon se Menaxhmenti nuk ka ndërmarrë veprime të mjaftueshme për materializimin e kontributeve të auditimit të brendshëm kundrejt përmirësimit të kontrolleve të brendshme dhe aktiviteteve operative.

Rreziku Niveli i ulët i implementimit të rekomandimeve të NjAB, do të ketë ndikim negativ në funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme si dhe rritë rrezikun që gabimet dhe mangësitë e njëjta të përsëriten në vazhdimësi.

Rekomandimi 6 Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, Kryetari duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me implementimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi i pasurive, realizimi i investimeve kapitale me kohë, inkasimi i mjeteve nga qiraja, monitorimi i subvencioneve, mbeten fushat, ku nuk janë zbatuar rregulloret duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para si dhe në vonesat në përfundim të projekteve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	850,000	850,000	845,683	759,595	749,986

Nga tabela shihet se pranimet gjatë vitit 2016 ishin 845,683€, ndërsa shuma e planifikuar ishte 850,000€. Në kudër të këtyre të hyrave hyjnë edhe të hyrat nga niveli qendror si gjobat e trafikut, dënimet nga gjykatat dhe nga Agjencia e Pyjeve në shumë 147,732€.

Të dhënat në tabelë tregojnë se komuna kishte bërë një plan mjaft real të THV, të cilin pothuajse e kishte përmbushë në tërësi.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	7,246,192	8,347,703	7,945,340	7,816,036	7,680,836
Granti i Qeverisë -Buxheti	6,396,192	7,156,258	7,142,934	6,900,558	6,955,289
Të bartura nga viti paraprak ³ -	-	312,481	223,232	377,619	349,890
Të hyrat vetjake ⁴	850,000	850,000	563,011	516,594	355,312
Donacionet e brendshme	-	11,068	-	4,465	2,345
Donacionet e jashtme	-	17,896	16,163	16,800	18,000

Planifikimi fillestar kishte mangësi, duke pasur parasysh që buxheti final në raport buxhetin fillestar ishte rritur për 1,101,511€. Kjo rritje është rezultat i një vendimi të Qeverisë Republikës së Kosovës në shumë prej 760,043€, të hyrat e bartura nga viti paraprak 312,481€ dhe nga grantet e përcaktuara të donatorëve prej 28,987€.

Në vitin 2016, Komuna ka përdorur 95% të buxhet final ose 7,945,340€.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	7,746,192	8,347,703	7,945,340	7,816,036	7,680,836
Pagat dhe Mëditjet	5,954,554	6,776,482	6,743,433	6,609,654	6,054,477
Mallrat dhe Shërbimet	653,765	712,166	589,778	506,706	524,928
Shërbimet komunale	180,700	244,604	230,762	160,095	170,609
Subvencionet dhe Transferet	100,567	107,817	100,212	113,121	178,025
Investimet Kapitale	356,606	506,634	281,155	426,460	752,797

Pavarësisht rritjes së buxhetit për shpenzime kapitale gjatë vitit, vetëm 55% e buxhetit ishte shpenzuar. Në kudër të kësaj përqindje përfshihen edhe projektet e viteve të më hershme që ishin paguar në vitin 2016, çka do të thotë se ekzekutimi i buxhetit për projekte të vitit 2016 bie në nivel edhe më të ulët.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të Komunave të pa shpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Çështja 7 - Realizimi i buxhetit - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Në buxhetin e investimeve kapitale të vitit 2016, ishin planifikuar për t'u realizuar dy (2) projekte në shumë prej 43,000€ të cilat nuk kishin filluar fare, ndërsa dy (2) projekte tjera në shumë prej 118,000€ ishin realizuar vetëm 27%, ndërsa ishte planifikuar që të realizohen brenda vitit.
- Rreziku** Realizimi i ulët i buxhetit për investime kapitale do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson shkaqet dhe barrierat për mos zbatim me kohë të investimeve kapitale dhe për bartjen e vazhdueshme të obligimeve në buxhetet e viteve vijuese.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2016 ishin në vlerë 845,683€. Burimet kryesore të hyrave vetjake të Komunës së Kamenicës janë tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksa administrative, taksa për regjistrimin e automjeteve si dhe të hyra të tjera. Të hyrat e planifikuara për vitin 2016 janë 850,000€, deri sa ky plan deri në fund të vitit ishte realizuar mbi 99%.

Testimet tona kanë vënë në pah mangësitë në vijim:

Çështja 8- Tatimi në pronë - Prioriteti i lartë

- E gjetura** Sipas UA 03/2011 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën e tatimpaguesve, neni 13 parashihet që komuna është e obliguar që çdo vit ta bëjë verifikimin në terren për 1/3-tën e pronave të regjistruara. Komuna për vitin 2016 ka arritë të bëjë verifikimin e vetëm 272 prej 15,886 të pronave ekzistuese, përkatësisht vetëm 2%.
- Rreziku** Mos realizimi i verifikimit i 1/3 të pronave ekzistuese mund të ndikojë në mungesën e të dhënave të sakta dhe të plota të pronës së tatueshme aktuale dhe rrjedhimisht ndikon që të hyrat e tatimit në pronë të ulen.
- Rekomandimi 8** Për të shmangur ndikimet e përmendura më lart, Kryetari duhet të përmirësoj procesin e verifikimit vjetor të pronave dhe të siguroj se verifikimi i pronave komunale, bëhet në baza të rregullta vjetore, dhe sipas kuotave të përcaktuara me Udhëzimet administrative.

Çështja 9 - Të hyrat nga qiraja - Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna kishte lëshuar në shfrytëzim më qira, shtatë (7) hapësira publike, mirëpo jo të gjithë shfrytëzuesit paguajnë qira më rregull. Vonesat në pagesën e qirasë ishin deri në shtatë (7) muaj, dhe nuk ishin arkëtuar as në kohën kur është përfunduar auditimi, ndërsa njëri nga ta edhe pas përfundimit të marrëveshjes kishte mbetur pa shlyer borxhin të komuna. Vlera totale e pa inkasuar nga qiraja e këtyre hapësirave ishte 90,351€. Komuna nuk ka mekanizma për aplikimin e gjobave në vonesa ose për arkëtimin e këtyre borxheve.
- Rreziku** Vonesat në pagesa të qirasë rrisin rrezikun që komuna të mos mund të arkëtojë asnjëherë këto shuma dhe gjithashtu rrit rrezikun potencial për keqpërdorime. Kjo mënyrë e operimit ndikon edhe në konkurrencën e lirë dhe shfrytëzimin e atyre hapësirave edhe nga qytetarët e tjerë.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të sigurojë që mekanizmat e duhur për mbledhjen e borxheve operojnë dhe duhet të sigurohet që të aplikohen gjobat në vonesat e caktuara dhe njëkohësisht të sigurohet transparencë, dhe trajtim i drejtë dhe i barabartë për të gjithë shfrytëzuesit e mundshëm gjatë dhënies së hapësirave me qira.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe Mëditjet paguhën përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë më: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqesin në mes të formularëve; rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin me thesar. Buxheti për kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 7,156,258 € ndërsa shpenzimet 7,142,934€ apo gati 100% e buxhetit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalitetë) në vitin 2016 ishte 956,770€. Prej tyre ishin shpenzuar 820,540€ apo 86% e buxhetit. Shërbimet komunale marrin pjesë në shpenzimet totale më 28%, derivate dhe dru për ngrohje 24%, mobilie dhe pajisje tjera 14% dhe zërat tjerë me të vegjël.

Çështja 10 - Marrëveshjet për shërbimet e veçanta – Prioritet i mesëm

E gjetura Numri i të angazhuarve përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta në Komunën e Kamenicës për vitin 2016 ishte 30. Prej tyre kemi testuar 10 mostra dhe kemi vërejtur se komuna nuk ka mbajtur tatimin në burim, ashtu siç kërkohet me ligjin për të ardhurat personale përkatësisht nenet 37 dhe 38.

Rreziku Mos ndalja e tatimit në burim për personat e angazhuar përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta, rrit rrezikun që Komuna të jetë objekt i ndëshkimeve nga autoritetet tatimore.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të sigurojë se punonjësit e angazhuar përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike, dhe mbajtja e tatimeve në burim të jetë në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 242,033€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 230,762€ apo 94% e buxhetit të planifikuar. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin e klubeve sportive, ndihma momentale e të tjera.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investimet kapitale ishte 506,634€. Prej tyre në vitin 2016 ishin shpenzuar 281,555€ apo 55% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve, trotuareve dhe kanalizimeve që në shpenzimet totale marrin pjesë me 84 %, pastaj ndërtesat (objektet shkollore, shëndetësore etj.) me 8%, automjete transporti 5% dhe zërat të tjerë me të vegjël.

Sa i përket dobësive në investime kapitale, janë trajtuar në pjesën e çështjeve të përbashkëta.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet, investimet kapitale si dhe subvencione dhe transfere:

Çështja 11 - Kohëzgjatja e kontratave - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Gjatë ekzaminimit të tenderëve kemi vërejtur se në katër (4) raste kontratat ishin nënshkruar pa e përcaktuar kohëzgjatjen e kontratës të shprehur në ditë kalendarike, por vetëm duke iu referuar planit dinamik në ditë pune tek pjesa e kushteve të veçanta të kontratës.
- Rreziku** Nënshkrimi pa definimin e kohëzgjatjes së kontratës në ditë kalendarike, rrit rrezikun që të ndodhin vonesa në realizimin e projekteve, në mbikëqyrjen e cilësisë së punimeve dhe periudhën e sigurisë së ekzekutimit.
- Rekomandimi 11** Kryetari duhet të sigurohet se të gjitha kontratat e nënshkruara përmbajnë afate të qarta kohore të cilat përcaktojnë periudhën kohore brenda të cilës kontratat duhet të përfundojnë.

Çështja 12 - Pagesa të shpenzimeve nga kategoria jo adekuate- Prioritet i lartë

- E gjetura** Pagesa në vlerë 8,259€ për blerjen dhe montimin e një kalldaje për ngrohje në gjimnazin "Xhavit Ahmeti" ishte klasifikuar gabimisht tek mallrat dhe shërbime, ndërsa është dashur të trajtohet si investim kapital;
- Ngjashëm, tri (3) pagesa tjera në vlerë totale 11,100€ ishin regjistruar gabim si mallra dhe shërbime, ndërsa është dashur të regjistrohen si investime kapitale. Kjo shumë kishte të bënte me mirëmbajtjen e rregullt të rrugëve dhe hapësirave gjelbëruese; dhe
- Planifikimi dhe menaxhimi jo i duhur i shërbimeve për trajtimin e qenve endacak ka shkaktuar mbivlerësimin e subvencioneve dhe transfereve në vlerë prej 4,555€. E gjithë kjo shumë do të duhej të paguhej nga mallrat e shërbimet.
- Rreziku** Pagesat nga kategoria e gabuar e shpenzimeve, shkaktojnë nënvlerësim dhe mbivlerësim të kategorive përkatëse, dhe ndikojnë në mos prezantim të drejtë të shpenzimeve në PFV.
- Rekomandimi 12** Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha shpenzimet regjistrohen në kategorinë e duhur, duke siguruar pasqyrim të saktë të shpenzimeve për të gjitha kategoritë.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Edhe pse komuna ka ndërmarrë hapa për të përmirësuar raportimin për pasuritë e saja, ende ekzistojnë disa mangësi në lidhje me menaxhimin e pasurisë së komunës dhe rekomandimet e vitit të kaluar janë adresuar vetëm pjesërisht.

Sa i përket pasurive kapitale dhe ndikimit të tyre në PFV, janë trajtuar tek pjesa 1.1 e këtij raporti.

Çështja 13 - Mos inventarizimi vjetor i pasurisë mbi 1000€ - Prioritet i mesëm

E gjetura Komisioni për inventarizimin e Pasurive jo financiare nuk kishte përfshirë pasurinë mbi 1,000€ për vitin 2016. Komisioni i njëjtë nuk kishte bërë as krahasimin e gjendjes së listave të inventarizimit të pasurisë jo financiare nën 1,000€ me gjendjen në regjistrat kontabël, të pasurive përkatëse jo financiare (Rregullorja 02/2013 neni 19 paragrafi 4.3).

Rreziku Mos inventarizimi i pasurisë mbi 1,000€ dhe mos krahasimi i gjendjes së listave të inventarizimit nën 1,000€, ndikon që komuna të mos ketë kontrollet e duhura mbi pasuritë, dhe të njëjtat t'i ekspozohen rrezikut për humbje apo keqpërdorime.

Rekomandimi 13 Kryetari i komunës duhet të sigurojë që komisioni i inventarizimit vjetorë të pasurisë jo financiare, të bëjë inventarizimin e plotë të pasurisë jo financiare dhe të bëjë krahasimin e saj me gjendjen në regjistrat kontabël. Diferencat e që dalin si rezultat i regjistrimeve, duhet të sqarohen me menaxhmentin dhe regjistrat përfundimtar, të prezantojnë gjendjen aktuale të pasurisë.

3.2.2 Të arkëtueshmet

Komuna e Kamenicës ka deklaruar llogari të arkëtueshme në vlerë 1,660,220€, nga të cilat 1,240,710€ nga tatimi në pronë, 310,100€ taksa komunale, 3,200€ nga qiraja, 13,200€ taksa komunale për leje të ndërtimit dhe 92,000€ shfrytëzimi i pronës publike. Krahasuar me vitin e kaluar këtë llogari janë zvogëluar për 209,780€. Komuna kishte arritur progres në uljen e të gjitha llogarive të arkëtueshme, përveç tatimit në pronë, mirëpo mbetet ende një sfidë që komuna të arrijë të inkasojë të gjitha llogaritë e arkëtueshme për vitet e ardhshme.

Sa i përket llogarive të arkëtueshme dhe ndikimit të tyre në PFV, janë trajtuar tek pjesa 1.2 e këtij raporti.

3.3 Obligimet e papaguara

Obligimet e deklaruara në PFV për vitin 2016 ishin 76,810€ kurse në vitin 2015 ishin 124,340€, që rezulton me një rënie të obligimeve për 47,530€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të zbatuara	Rekomandimet pjesërisht të zbatuara	Rekomandimet e pa zbatuara
1.4 Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura, përfshirë rrezikun domethënës për pasuritë. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime.			Ende ekziston rreziku domethënës i pasurive kapitale. Ende ka pasuritë të paregjistruara nga viti 2015, keqklasifikime duke mbivlerësuar pasuritë.
	Kryetari duhet të sigurojë se ZKF raporton në mënyrë sistematike mbi progresin e IK-ve. Aty ku është e nevojshme, duhet të azhurnohen projektet në programin e IK-ve, në mënyrë që kërkesat e ardhshme buxhetore të jenë bërë në bazë të nevojave reale për investime.	Është adresuar		
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Pjesërisht, sepse ende ka rekomandime të pa zbatuara.	

2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Gjithashtu, sa i përket objektivave strategjike komunale, Kryetari duhet të caktojë ekip përgjegjës i cili harton planin e veprimit për rekomandimet e zbatueshme. Dokumentet e tilla nuk duhet të mbesin vetëm të shkuara në letër.		Ende mungojnë dokumentacionet mbështetëse, të plotësimit të listës kontrolluese të vetëvlerësimit.	
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njëjësive do të menaxhojë këtë proces dhe do të raportojë në baza të rregullta mbi rreziqet.			Nuk ka delegim të përgjegjësive për menaxhimin e rreziqeve tek një drejtor apo menaxher.
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.		Pjesërisht, sepse ende nuk ka raportim të rregullt tek menaxhmenti i lartë.	
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike dhe janë identifikuar barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku mund të bëhen përshtatjet për reduktim të shpenzimeve operative, të njëjtat të rishikohen për koncentrim në projekte kapitale.		Pjesërisht, sepse ende është i ulët realizimi i buxhetit tek investimet kapitale.	

3.4 Prokurimi	Kryetari të sigurojë se është kryer një shqyrtim për të përcaktuar pse në rastet e mësipërme kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë. Rrjedhimisht, duhen vendosur kontrole të shtuara për të siguruar që një situatë e ngjashme nuk do të përsëritet në prokurimet e ardhshme.	Është adresuar		
3.5.1 Shpenzime tjera	Kryetari duhet të sigurojë se kontratat për shërbime të veçanta përdoren vetëm për qëllimin e caktuar, planifikohen drejtë dhe bëhen në pajtim me ligjin. Ne sugjerojmë që kjo praktikë të ndërpritet sa më parë.			Ende kishte të punësuar më kontrata për shërbime të veçanta.
	Kryetari duhet të rishikoj rastet e mësipërme dhe të merr masat e duhura. Gjithashtu, duhet të sigurojë se zyrtarët respektojnë në tërësi kërkesat e rregullores së brendshme për përdorimin e veturave zyrtare. Personat përgjegjës për mbikëqyrjen e autoparkut duhet të sigurojnë se automjetet zyrtare përdoren vetëm nga personat e autorizuar dhe me fletudhëtime të plotësuara dhe të aprovuara nga menaxhmenti i komunës.			Kemi ende automjete që shfrytëzohen nga zyrtarët komunal por nuk mbajnë fletudhëtime për shfrytëzimin e automjeteve zyrtare.
3.5.3 Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të sigurojë se procedura efektive zbatohen me rastin e dhënies së subvencioneve si dhe respektohen kriteret e rregullores. Sa i përket subvencioneve për arsimin jo formal, të ushtrohet mbikëqyrje e vazhdueshme për t'u siguruar se mjetet derdhen në llogarinë e buxhetit komunal. Gjithashtu, të bëhet monitorim i vazhdueshëm i shpenzimeve të subvencioneve në mënyrë që të sigurohen raporte të vlefshme për arsyeshmërinë e shpenzimeve.		Pjesërisht për arsye se ishin bere pagesat e shërbimeve nga kategoria e subvencioneve.	

3.6 Të hyrat	Kryetari duhet të mbikëqyrë në mënyrë të veçantë procesin e të gjitha qiradhëniesve komunale, me theks të veçantë në nevojën për mbështetje me bazë kontraktuale të çdo prone të lëshuar me qira. Komuna duhet të jetë më rigorozë në mbledhjen e borxheve nga qiraja, ndërsa obliguesve që nuk kanë paguar qiratë, t'iu ndërpritet mundësia e shfrytëzimit të mëtejshëm të pronave.			Ende mbeten borxhet e pa inkasuara.
	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e rishikimit të buxhetit bëhet përshtatje e planifikimit të të hyrave, bazuar në trendin e inkasimit të periudhave të mëparshme dhe kompleksitetin e operacioneve ekzistuese. Gjithashtu, të verifikohet legjitimiteti i faturimit të objekteve në regjistrin e tatimit në pronë dhe të dhënat të azhurnohen sipas kërkesave ligjore mbi pronën e paluajtshme. Më tej, zyra e tatimit në pronë të shfrytëzoj të gjitha burimet për verifikim të pronave.			Ende nuk ka verifikim të pronave të paluajtshme sipas kërkesave ligjore.
3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të formoj komisione për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të të gjitha pasurive jo financiare si dhe të monitoroj rezultatet e vlerësimit. Rezultatet e regjistrimit duhet të integrohen në një regjistër të vetëm për të gjithë sektorët. Zyrtari për menaxhim të pasurisë dhe zyrtarët e angazhuar në pranimin e pasurive komunale të komunikojnë në mënyrë efektive për të shmangur mos zbatimin e kërkesave të rregullores dhe mos konsolidimin e vlerës së pasurive.			Komisioni për inventarizimin e pasurisë nuk kishte bere regjistrimin e pasurisë mbi 1000€.Po ky komision nuk kishte bërë krahasimin e shënimeve të regjistrave të inventarizimit më regjistrat kontabël te pasurive.

3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari duhet të shqyrtojë vjetërsinë dhe vlefshmërinë e borxheve individuale dhe të zbatojë një proces sistematik të trajtimit të atyre borxheve që konsiderohen të pa mbledhshëm duke i trajtuar të gjitha në mënyrë të veçantë, në Kuvendin Komunal.		Mungon ende trajtimi i borxheve që konsiderohen të pa mbledhshëm.	
3.7.3 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të sigurojë se drejtorët vlerësojnë në baza mujore, të gjitha faturat e papaguara dhe në mënyrë formale raportojnë tek ZKF. Po ashtu, konfirmime formale duhet të sigurohen nga departamentet komunale se të gjitha faturat e papaguara i janë proceduar për pagesë shërbimit të financave.	Faturat e papaguara raportohen dhe procedohet për pagesë		
	Gjithsej:	3	6	7

Shtojca IV: Letër konfirmimi

Republika e Kosovës
Komuna e Kamenicës

REPUBLIKA E KOSOVES
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

30.05.2017

Fjalë e mirë Drejtues	Shtetësi Klasifikim Klasifikim	Nr. Prot. Dr. Prot. Prot. No.	Shtetësi Dr. Shtetësi No. Prot.
12	22-29	583	1

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Kamenicë: 30.05.2017

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Kamenicës, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raport");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe kemi komente për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari:

Begzad Sinani

